



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1138 / Prot
1

Tiranë, më 9 / 10 / 2020

VENDIM

Nr. 44 , datë 9 . 10 . 2020

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1138 Prot., datë 23.09.2020, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Kryeministria” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet e-mail-it datë 01.10.2020, ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion dokumentacioni, si më poshtë:

- 1- *Një kopje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 23.02.2018.*
- 2- *Një kopje të plotë të dosjes së kontratës së nënshkruar ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë “APCO WORLDWIDE”.*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të vlerëson se, ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me e-mail-in e datës 29.09.2020, ka kërkuar nga Autoriteti Publik informacion lidhur me procedurën e ndjekur apo trajtimin e kërkesës për informacion, si dhe bazuar në nenin 17, pika 5 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, vlerësimin e rishikimit të klasifikimit të informacionit.

Koordinatorja për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, ka kthyer përgjigje duke informuar Zyrën e Komisionerit se *informacioni i kërkuar vijon të jetë i klasifikuar, si dhe ka parashtruar se argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik, për të njëjtin objekt kërkimi, por me subjekt tjetër, është mbështetur gjithashtu edhe nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, nëpërmjet vendimit me nr. 1639, datë 21.07.2020, i cili ka marrë formë të prerë.*

Gjithashtu, për të njëjtin objekt kërkimi Zyra e Komisionerit ka marrë në shqyrtim një ankesë të depozituar nga i njëjti ankues, ndaj Autoritetit Publik/Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, i cili ka rezultuar si autoriteti i klasifikimit origjinal të këtij akti.

Në lidhje me këtë procedurë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me shkresën nr. 11154/1 Prot., datë 01.10.2020, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1113/2 Prot., datë 02.10.2020, ka bërë me dije ndër të tjerat se: “*...Akti administrativ VKM-ja nr.115, datë 23.02.2018 dhe dokumentacioni që lidhet me të, janë akte, të cilat janë hartuar dhe administrohen në bazë të ligjit nr.8457, datë 11.02.1999 “Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror”. Bazuar në parashikimet e pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, strukturat e MEPJ-së të ngarkuara në administrimin e informacionit të klasifikuar kanë marrë në shqyrtim për mundësinë e deklasifikimit të këtij informacioni. Pas analizës së kërkesës dhe vlerësimit të informacionit të klasifikuar, mbështetur edhe në nenin 13, të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror”, u arrit në përfundimin se ky informacion nuk mund të deklasifikohet. Sa më sipër, mbështetur në pikën 2/a të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, MEPJ nuk mund të vendosë në dispozicion aktet e kërkuara nga ana e kërkuesit”.*

Nga shqyrtimi i çështjes konstatohet se objekti i kërkesës ka të bëjë me informacion, i cili rregullohet dhe i nënshtrohet gjithashtu dhe dispozitave të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror”, i ndryshuar.

Në nenin 13, të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Autoriteti i klasifikimit origjinal është njëkohësisht edhe autoritet deklasifikues. Ai deklasifikon informacionin e klasifikuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji*”.

Në këto kushte, pavarësisht se në parim informacioni i kërkuar përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në rastin konkret publikimi i tij kufizohet në përputhje me shkronjën a) të pikës 2 të nenit 17, të ligjit të sipërcituar.

Pika 2 e nenit 17 të Kodit të Procedurave Administrative parashikon se: *“Palët që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë”*

Për rrjedhojë, mbështetur në sa më sipër parashtruar, Komisioneri vlerëson se ankesa e z. ndaj Autoritetit Publik/Kryeministrisë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 1138 Prot., datë 23.09.2020 të z. , kundër Autoritetit Publik “Kryeministrisë”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 09.10.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

